



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakt i raportit përfundimtar të revizionit

Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Partia politike Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë - LSDM

Lënda e revizionit:

Pasqyrat financiare të Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë për vitin 2019, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë

Qëllimi i revizionit:

A janë pasqyrat financiare të lira nga gabime në të gjitha aspektet materiale, si dhe aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to, a janë në përputhje me dispozitat ligjore.

Gjendjet kyçe të identifikuara:

- Disa nga objektet e trashëguara kanë status të pazgjidhur pronësie dhe ato nuk janë të regjistruara në regjistrat dhe
- tarifa mujore e anëtarësisë nga secila organizatë komunale, në shumë totale paguhet drejtpërdrejt në llogarinë e transaksionit, për shkak të së cilës nuk jepet mundësia për inspektim të plotë dhe konfirmim të mjeteve individuale të paguara për anëtarësim

Rekomandimet kyçe:

- Vazhdimi i aktiviteteve për përcaktimin e pronësisë së objekteve dhe regjistrimi i tyre dhe
- rregullimi i mëtejshëm i mënyrës së mbledhjes, pagesës dhe njoftimit për mjetet e grumbulluara nga tarifa për anëtarësim

Vërejtjet e marra mbi draft Raportin:

Nuk janë marrë vërejtje mbi draft raportin e Revizorit të autorizuar shtetëror.

Opinion i dhënë*:

Kemi shprehur opinion me rezervë në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e pasqyrave financiare, si dhe për pajtueshmërinë me legjislacionin, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Të rishikohen dispozitat ligjore në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore me mjete nga llogaria e rregullt; precizim në pjesën e financimit të procesit zgjedhor nga donacionet nga partitë politike, në lidhje me limitet individuale dhe totalë të mjeteve; ndryshime dhe plotësime në aktet ligjore që rregullojnë mënyrën e kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse dhe rregullimin e mënyrës së pagesës, pagesës dhe regjistrimit të tarifave për anëtarësim si burim i financimit

Përgjigja ndaj vërejtjeve të marra:

/

*  pozitive,  me rezervë,  i pafavorshëm,  i përmbajtur